



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva
i Ruralnog Razvoja/Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**
Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/Agencije za Razvoj Poloprivrede/ The Agriculture Development Agency

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë , mbështetur në Ligjin nr. 03/L-149, për “Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës”, dhe Rregullores nr. 02/2010, “Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil”, me qëllim të realizimit të procedurave të rekrutimit shpall:

KONKURS (i Brendshëm)

Titulli i pozitës: Drejtor i Drejtorisë për Administratë

Ref: RN00002544

Njësia Organizative: Drejtoria e Administrates - AZHB

Vendi i punës: Prishtinë

Kategoria funksionale: Niveli drejtues

Koeficienti: 10

Qëllimi i vendit të punës:

Qëllimi i punës së Drejtorit të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme është për të organizuar, menaxhuar dhe koordinuar punën në Drejtorinë për Administratë të Përgjithshme, menaxhon dhe zbaton kontrollet mbikëqyrëse, menaxhon çështjet juridike, të përgjithshme dhe në lidhje me menaxhimin e dokumentave, menaxhon dhe koordinon aktivitetet në lidhje me përgatitjen e dokumenteve ligjore të punës së AZhB-së, menaxhon dhe koordinon aktivitetet për furnizim me materiale dhe menaxhimin e burimeve njerëzore, edukimin, dhe koordinimin e planifikimit financiar.

Detyrat kryesore:

1.Menaxhimi i Drejtorisë 10%

2.Implementimi i Kontrolleve dhe Raportimi mbi fushën e punës 15%

3.Aktivitetet e koordinimit për çështjet juridike, çështjet e përbashkëta, burimet njerëzore dhe menaxhimin e dokumenteve 15%

4.Përgatitja e akteve Ligjore të Agjencisë 10%

5.Koordinimi i aktiviteteve për mbështetjen e operacioneve të përbashkëta të Agjencisë, burimet dmth financiare, burimet njerëzore, burimet materiale, logjistika 5%

6.Koordinimi i aktiviteteve për planifikimin financiar, planifikimin e burimeve materiale dhe blerjeve dhe zbatimin e prokurimit publik 10%

7.Menaxhimi i Burimeve Njerëzore 25%

8.Menaxhimi i Arsimit 5%

9.Kryen edhe punë të tjera sipas udhëzimeve të Eprorit 5%

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkua:

Njohuri paraprake ne fushën e administrates;

Diploma Universitare: **Shkenca të Ekonomisë, Juridik ose Relevante;**

Përvoja në punë: 6 vite përvojë pune profesionale - 3 vite përvoj në vende udheheqese;

Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point,Access)

Fleksibilitet dhe aftësi për t'u përballë me situata të reja;

Shkathtësi ne menaxhim, organizim, caktim te objektivave dhe planifikim;

Njohja e gjuhës angleze e preferuar.

Data e shpalljes së konkursit me: 14.12.2017

Data e mbylljes së konkursit me: 21.12.2017

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Aplikacionet e dorëzuara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të aplikacioneve të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Procedura e Aplikimit: Formularët për aplikim mund të merren dhe dorëzohen në Sektorin e Personelit në Agjencionin për Zhvillimin e Bujqësisë - M B P Z H R , Ndërtesa e Bankës së Lublanës Kati i VII , Zyra nr. 23 ose të shkarkohen në adresën e internetit të AZHB-së www.azhb-ks.net.